



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 203/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/04/2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva s.c.p.a.” degë e shoqërisë së huaj (d.sh.h.) në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-21321-12-29-2015 me objekt “Ndërtim i Rrugës Dhimitër Konomi (mbi Rrap) Vlorë” me fond limit 408,175,256 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 27.01.2016 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

BO “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h.
Adresa: Rr “Themistokli Gërmenji” 3/1
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rr “Sami Frashëri” Nr.10
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë

17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.12.2016 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-21321-12-29-2015 me objekt “Ndërtim i Rrugës Dhimitër Konomi (mbi Rrap) Vlorë” me fond limit 408,175,256 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 27.01.2016 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2 . Në datën 27.01.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative rezulton se në datën 29.02.2016, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "CAUSHI/M" sh.p.k.	261,521,000	Lekë	skualifikuar;
2. "RSM Company" sh.p.k.	276,464,422	Lekë	skualifikuar;
3. "Company Riviera 2008"	280,575,438	Lekë	skualifikuar;
4. "Curri" sh.p.k.	290,957,430	Lekë	skualifikuar;
5. BO "Riviera" sh.p.k. & "Kostruttiva" degë e shoqërisë së huaj	325,102,100	Lekë	skualifikuar;
6. "Alba Konstruksion" sh.p.k.	327,613,890	Lekë	skualifikuar;
7. "B-93" sh.p.k.	335,597,220	Lekë	skualifikuar;
8. "Tirrena Scavi" S.p.A.	336,635,315	Lekë	skualifikuar;
9. "Arifaj" sh.p.k.	348,924,499	Lekë	skualifikuar;
10. "Victoria Invest International" sh.p.k.	360,087,983	Lekë	skualifikuar;
11. "A. N. K." sh.p.k.	364,625,890	Lekë	kualifikuar;
12. "ALB - STAR sh.p.k.	365,225,026	Lekë	skualifikuar;
13. "ALKO-IMPEX General Construcion" d.sh.h.	366,500,600	Lekë	skualifikuar;
14. "GENER 2" sh.p.k.	375,977,276	Lekë	kualifikuar;
15. "T.T.A ALBA LAM" sh.p.k.	388,623,101	Lekë	skualifikuar;
16. "SENKA/L" sh.p.k.	400,000,000	Lekë	skualifikuar;
17. "ROSI" sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike			

II.3.1. Bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se : "[...]

1. Të skualifikojë bashkimin e përkohshëm të shoqërive "Riviera" shpk (51%) dhe "Kostruttiva" shpk (49%) për arsye se: Shoqëria "Kostruttiva" shpk nuk plotëson pikën 2 të Kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim pasi vërtetimi i lëshuar nga Agenzia Entrate mban datën 14 shtator 2015, pra është përtej afatit tre mujor të vlefshmërisë.
2. Shoqëria "Kostruttiva" nuk plotëson kërkesën 2.1.e të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit lidhur me likuidimin e detyrimeve të OSHEE pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e kërkuar. Për të provuar likuidimin e detyrimeve ka paraqitur një librezë (që nuk kuptohet se kujt i përket), një kontratë nënqeraje me zotin Trojan Pavllofski dhe një vërtetim nga OSHEE që zoti Trojan Pavllofski nuk rezulton debitor ndaj OSHEE. Këto dokumenta nuk provojnë që shoqëria "Kostruttiva" nuk ka detyrime ndaj OSHEE.
3. Shoqëria "Kostruttiva" shpk nuk plotëson pikën 2.4.5 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me disponimin e licensave, pasi mungon pika e licensës NS 18 "Punime topogjeodezike", e domosdoshme për të realizuar punimet që ka marrë përsiper kjo shoqëri sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

4. Shoqëria “Riviera” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kërkesave të Përgjithshme të Kualifikimit pasi ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Tatimore Tirane, në të cilin , ndër të tjera citohet: “... rezulton se për periudhën deri në datë 08.01.2016, nuk ka detyrime tatimore në tvsh, tatim fitimi, tatim mbi të ardhurat personale, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatim në burim, por vetëm gjoha dhe interesa për të cilat ka lidhur aktmarrëveshje për pagesat me këste...”. Në këtë menyre, duke qenë se ky subjekt përveç gjobave ka edhe interesa të pa paguar, nuk plotëson këtë kërkesë për kualifikim.
5. Shoqëria “Kostruttiva” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim “Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit duhet të mos jetë më e vogël se 350.000.000 lekë pa tvsh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ku vlera të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit”pasi nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron e realizuar.
6. Shoqëria “Riviera” shpk nuk plotëson pikën 2.4.1 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”. Për të provuar plotësimin e këtij kushti shoqëria “Riviera” shpk ka paraqitur një kontrate të lidhur me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit në Kosove, nënshkruar në datën 27.07.2009, me objekt: “Zgjerimi i rrugës nacionale M2 segmenti rrugor prishtinë – udhëkryqi M2 R120 (Millosheve), Loti 4”. Kontrata nuk është e plotë, pasi mungojnë të gjithë anekset e kontratës. Në këtë kontratë punimet merren përsipër të zbatohen nga bashkimi i shoqërive “Riviera” shpk (50%) dhe “Toni Com” (50%). Për këtë kontratë janë paraqitur edhe tre fatura: fatura nr 2112001 datë 21.12.2012 me vlerë 313.024,16 Euro pa tvsh, fatura nr 2012001 datë 20.12.2012 me vlerë 298.312,70 Euro pa tvsh dhe fatura nr. 2312002 date 22.12.2015 me vlerë 238.844.09 euro pa tvsh. Duke qenë se në kërkesat për kualifikim kërkohen pune të kryera në tre vitet e fundit, rezulton se vetëm punët e faturuara me faturën nr. 2312002 date 22.12.2015 me vlerë 238.844.09 euro pa tvsh janë realizuar në periudhën e kërkuar. Duke qenë se shoqëria “Riviera” shpk ka kryer vetëm 50% të këtyre punëve, vlera e punës së realizuar prej saj është rreth 16.719.080 leke pa tvsh ndërkohë që duhet të paraqiste dokumentacion për realizimin e punëve të ngjashme në masën 204.087.628 leke pa tvsh në një punë të vetme. [...]”

II.4. Në datën 04.03.2016, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: “[...] Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit, ju bëjmë me dije se shoqëria “Kostruttiva” s.c.p.a është një shoqëri e regjistruar në në Itali e cila rregullohet nga ligjet e shtetit të origjinës, pra shtetit Italian. Dokumenti i paraqitur në tender “Agenzia Delle Entrate” është një vërtetim i cili provon mungesën e çdo debie ndaj shtetit Italian për të gjithë sistemin e taksave pasi vërteton mungesën e detyrimeve fiskale të Kostruttiva SCPA. Në këtë rast, siç citohet edhe në vërtetimin e lëshuar nga “Agenzia delle Entrate”, në nenin 41 pika 1 DPR n.445 datë 28.12.2000 përcaktohet vlefshmëria e këtij vërtetimi e cila është mbi 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit. Pra mbi këtë dhe çdo dokument tjetër të shoqërisë “Kostruttiva” SCPA vepron ekzkluzivisht ligji dhe normativa italiane dhe nuk vepron në asnjë mënyrë të mundshme ligji dhe normativa shqiptare cili rregullon vlefshmërinë e vërtetimeve shqiptare. Pra skadenca tre muaj e cituar nga ju është absolutisht e gabuar. Referuar ligjit të prokurimit publik neni 45 pika dh) përcaktohet: “Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur: dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës” Në lidhje me arsyen e skualifikimit se “Shoqëria “Kostruttiva” nuk plotëson kërkesën 2.1.e të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit lidhur me likuidimin e detyrimeve të OSHEE pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e kërkuar. Për të provuar likuidimin e detyrimeve ka paraqitur një librezë (që nuk kuptohet se kujt i përket), një kontratë nënqeraje me zotin Trojan Pavllofski dhe një vërtetim nga OSHEE që zoti Trojan Pavllofski nuk rezulton debitor ndaj OSHEE. Këto dokumenta nuk provojnë që shoqëria “Kostruttiva” nuk ka detyrime ndaj OSHEE. Duke ju referuar këtij motivi skualifikimi ju bëjmë me dije se shoqëria “Kostruttiva” S.c.p.a. ka një kontratë nënqeraje me z. T.P, pronar i pasurisë së paluajtshme në të cilën kjo shoqëri ka selinë ligjore të saj të regjistruar dhe deklaruar në QKR. Si rrjedhojë vërtetimi lidhur me likuidimin e detyrimeve të OSHEE merret vetëm në emër të pronarit të objektit dmth. Z. T.P. Si rrjedhojë në bazë të konceptit minimal juridik, ka prezantuar siç e konfirmoni ju, kontratën e nënqirasë me pronarin T.P.librezën e shlyerjes së detyrimeve nga ky i fundit dhe vërtetimin në emër të pronarit të objektit të paluajtur, pra selisë së “Kostruttivës”. Pra objekti pronë e z. T.P. nuk ka detyrime, i njëjti objekt është edhe selia ligjore në Tiranë e Shoqërisë “Kostruttiva” e cila si rrjedhojë nuk ka detyrime në OSHEE. Në lidhje me arsyen e skualifikimit “Shoqëria “Kostruttiva” shpk nuk plotëson pikën 2.4.5 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me disponimin e licensave, pasi mungon pika e licensës NS 18 “Punime topogjeodezike”, e domosdoshme për të realizuar punimet që ka marrë përsiper kjo shoqëri sipas marrëveshjes së bashkëpunimit” ju sqarojmë se palët kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi midis tyre datë 26.01.2016 ku parashikohet bashkimi i të gjitha kapaciteteve teknike, personleti, ekspriencës, makinerive etj, për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Shoqëria “Kostruttiva” s.c.p.a. nëse vini re ka një licencë italiane dhe një të njësuar nga Ministria e Transporteve me kategoritë e palimituara në nivelet më të larta të specializimit të punëve të cilat ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Është shumë tendencioz ky motiv skualifikimi megjithatë në çdo rast e mbulon anëtari dhe kryetari i grupit “Riviera” sh.p.k. Në lidhje me arsyen e skualifikimit “Shoqëria

“Riviera” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kërkesave të Përgjithshme të Kualifikimit pasi ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Tatimore Tirane, në të cilin, ndër të tjera citohet: “... rezulton se për periudhën deri në datë 08.01.2016, nuk ka detyrime tatimore në tvsh, tatim fitimi, tatim mbi të ardhurat personale, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatim në burim, por vetëm gjoba dhe interesa për të cilat ka lidhur aktmarrëveshje për pagesat me këste...”. Në këtë menyre, duke qenë se ky subjekt përveç gjobave ka edhe interesa të pa paguar, nuk plotëson këtë kërkesë për kualifikim”, ju sqarojmë se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet se: Një dokument që vërteton se (subjekti juaj): a) ka plotësuar detyrimet fiskale, b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , të lëshuar nga Administrata Tatimore. Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës. Për të plotësuar kriterin e mësipërm është paraqitur vërtetimi nr.1127 datë 08.01.2016 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ku vërtetohet “Subjekti nuk ka detyrime tatimore në TVSH, tatim fitim,tatim mbi të ardhurat personale, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatim në burim, por vetëm gjoba dhe interesa për të cilat ka lidhur akt marrëveshje për pagesë me këste me nr.40445/1 prot datë 25.06.2016. Ashtu sikundër shprehur Administrata tatimore në vërtetimin e lëshuar prej saj nr.1127 datë 08.01.2016, subjekti nuk rezulton të ketë detyrime tatimore. Përderisa vetë institucioni kompetent tatimor konfirmon se subjekti nuk ka detyrime tatimore, atëherë nuk ka vend për interpretime të mëtejshme për këtë çështje. KVO do ti lindte e drejta dhe nevoja të bënte interpretim të vërtetimit në referencë të ligjit të prokurimit dhe praktikës juridike të KPP për kazuset në të cilat administrata tatimore shprehet se subjekti ka detyrime tatimore të pa paguara në gjoba dhe interesa, kamatvonesa, etj. Të cilat janë pjesë akt marrëveshjes me administratën etj. Por administrata Tatimore sipas sistemit të tyre tatimore për subjektin tonë nuk ka detyrime tatimore për të cilat do të kishte ndërmarrë hapa të mëtejshëm për mbledhjen e tyre nga subjekti ynë duke zbatuar procedurat tatimore në fuqi. Organi tatimor që ka lëshuar vërtetimin me qëllim pjesëmarrje në tender (e cilësuar qartë në vërtetim ky fakt) nëse do ta konsideronte detyrim, me termat e kërkuar nga kriteri në DST, do të ishte shprehur vetëm që, subjekti rezulton me detyrime tatimore dhe në këtë rast ju si KVO do t’ju lindte e drejta të bënit interpretim të mësipërm. Në lidhje me arsyen e e skualifikimit me argumentin se “Shoqëria “Kostruttiva” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim “Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit duhet të mos jetë më e vogël se 350.000.000 lekë pa tvsh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ku vlera të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit”pasi nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron e realizuar” ju sqarojmë se “Kostruttiva” S.c.p.a. është një shoqëri e regjistruar në Itali e cila rregullohet nga ligjet e shtetit të origjinës, pra të shtetit Italian. Në këtë rast ky vërtetim nuk lëshohet në vendin e origjinës, ky vërtetim lëshohet vetëm në shtetin shqiptar dhe si rrjedhojë i kërkohet shoqërive shqiptare. Shoqëria për këtë pikë ka prezantuar një deklaratë, ku deklaron xhiron të tre viteve të fundit të kërkuar nga kjo pikë e dokumentave standarde të tenderit dhe e konfirmuar nga bilancet

e paraqitura gjithashtu. Në lidhje me arsyen e fundit të skualifikimit ju sqarojmë se referuar DST, kriteret teknike: Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion edhe për punimet e shtrimit me pllaka guri Porfido, të shtruara në mënyrë dekorative. Subjekti ka paraqitur kontratën e ngjashme “Zgjerim i rrugës Nacionale M2 segmenti rrugor Prishtinë-Milloshëvë, Loti 4 me autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës Kosovë nënshkruar më datë 27.07.2009. Në lidhje me këtë objekt në përputhje me kriteret e vendosura nga AK janë paraqitur: Kontrata me entin prokurues nr.datë 27.07.2009; Aneks Kontrata nr.2724 datë 23.05.2014 me vlerë 112,310.06 Euro; Akt kolaudimi përfundimtar (pranimi teknik) datë 14.12.2015; Situacioni përfundimtar i punimeve; Referencë nga Autoriteti Kontraktor; Fatura të punimeve; Objekti në fjalë prokurohet me fonde të buxhetit të shtetit. Në këtë rast ligji në fuqi i prokurimit publik nr.9643 datë 2006 (i ndryshuar) përsa i takon eksperiencës dhe punimeve të ngjashme përcaktuese është neni 26 pika 6 i LPP ku rastet klasike të kualifikimit janë dy neni 6/a dhe neni 6/b. BO Riviera dhe Kostruttiva është në kushtet e plotësisht të pikës 6/a: “Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.” Ky nen sqaron gjithashtu se për të provuar punën e ngjashme Autoriteti Kontraktor kërkon: “Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloji dokumenti tjetër që parashikohet në legjislacionin në fuqi për të vërtetuar përmbushjen e sukseshme të punëve. Konkretisht nëpërmjet referencës së punime nr.26 datë 12.01.2016 dhe Akt Kolaudimi datë 14.12.2015 provohet që kompania e plotëson kriterin pasi vlera e punës së krye përmbush parashikimet e ligjit sipas nenit 26 pika 6.a. Vlera totale e punës së realizuar konfirmuar në akt kolaudim është në vlerën 5,861,123 Euro. Referuar situacionit përfundimtar dhe akt kolaudimi të veprës është sqaruar dhe mund të verifikohet lehtësisht se zbatimi i veprës nuk është përfunduar në afatin e parashikuar në kontratë pasi ka patur problem me shpronësimet të cilat kanë passjellë zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve. Për këtë punë të ngjashme nuk janë paraqitur shtyrje të afatit të punimeve pasi nuk ka të tilla siç mund të kontatohet nga Akt-Kolaudimi i veprës. Duke qenë se investitori nuk ka bërë akte të veçanta për shtyrjen e afatit është bërë pranimi pjesor të veprës deri në momentin e zgjidhjes së problemit të shpëronësimeve nga organet kompetente shtetërore në Kosovë, të cilën do ta bashkëlidhim si fakt në këtë ankesë. Në interpretim të drejtë të ligjit të prokurimit për përcaktimin që i bën për ekspriencën e ngjashme është plotësisht e qartë dhe e pagabueshme e cila nuk ka vend për asnjë lloj tjetër intepretimi përgjysmimi apo përllogaritje të faktit që Akti i kolaudimit është dokumenti teknik që provon përfundimin me sukses dhe dorëzimin e punës së kryer. Data e hartimit të këtij dokumenti përbën pikënisjen për përllogaritjen e afatit 3 vjeçar brenda së cilës operatori ka një punë të vlefshme të kryer në raport me datën e shpalljes së tenderit. Për sa më sipër, puna e ngjashme e

paraqitur nga ne si operator e plotëson kriterin e vendosur si dhe është një tregues i qartë për kapacitetin teknik të operatorit duke garantuar autoritetin kontraktor për realizimin e këtij objekti. [...]"

II.6. Në datën 04.3.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.334/2 prot datë 04.03.2016 i kthen përgjigje palës ankimese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik.

II.6.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: "[...] Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit, Komisioni vëren se në pikën 2 të Kërkesave të përgjithshme për kualifikim është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë një dokument që vërteton se Një dokument që vërteton se (subjekti juaj): a) ka plotësuar detyrimet fiskale, b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,të lëshuar nga Administrata Tatimore. Për të provuar plotësimin e pikës 2 të Kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim shoqëria "Kostruttiva" ka paraqitur një vërtetim të lëshuar nga "Agenzia Entrate" e cila mban datën 14 shtator 2015. Në dokumentet Standarde të Tenderit është kërkuar që Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës. Në këtë mënyrë kjo shoqëri nuk e plotëson këtë kusht, pasi dokumenti është lëshuar më parë se tre muaj nga data e hapjes së ofertave. Referimi i ankimesi i bën nenit 45 pika "dh" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" në të cilin citohet " Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur: dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës" është i gabuar pasi kjo e pikë e ligjit nuk i referohet afatit të vlefshmërisë së dokumentave, por detyrimin për pagimin e taksave. Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit, Komisioni vëren se në pikën 2.1. të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit është kërkuar që operatori ekonomik të dorëzojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Duket qartë se kërkesa nuk i referohet vetëm selisë, por të gjithë kontratave të mundshme që operatori ka në Shqipëri. I vetmi autoritet që mund të lëshojë një vërtetim të tillë është OSHEE. Me dokumentacionin e paraqitur shoqëria "Kostruttiva" ka vërtetuar se nuk ka detyrime ndaj qeradhënsit z. T.P dhe se ky i fundit nuk ka detyrime ndaj OSHEE, por në këtë mënyrë nuk vërtohet se shoqëria "Kostruttivva" ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit, Komisioni vëren se në pikën 2 të kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë një dokument që vërteton se subjekti a) ka plotësuar detyrimet fiskale, b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,të lëshuar nga Administrata Tatimore. Për ta provuar plotësimin e pikës 2 të Kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim shoqëria "Riviera" sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimore Tiranë, në të cilin, ndër të tjera citohet "rezulton se për periudhën datë 08.01.2016 nuk ka

detyrime tatimore në TVSH, Tatim Fitim dhe Tatim mbi të Ardhurat Personale, Sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatim në burim, por vetëm gjopa dhe interesa për të cilat ka lidhur aktmarrëveshje për pagesat me këste.” Në këtë mënyrë , duke qenë se ky subjekt përveç gjobave ka edhe interesa të pa paguara, nuk plotëson këtë kërkesë për kualifikim. Për sa më sipër, pretendimi i parashtruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron. Lidhur me arsyen e skualifikimit Komisioni vëren se në pikën 2.4.5. të kërkesave të veçanta për kualifikim, ndër të tjera është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë pikën e licencës N.S. 18.A. “Punime Topogjezike” Kjo shoqëri nuk e disponon këtë pikë. Komisioni pasi shqyrtoi marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet dy shoqërive pjesëmarrëse në tender, konstatoi se shoqëria “Kostruttiva” ka marrë përsipër të kryejë 49 % të punimeve që konstojnë në punime bordure, kuneta, trotuare, skarpate, punime në rrjetin e ujësjellësit, punime në rrjetin e kanalizimeve (f.v tub betony d=800 mmm), ndërtim tombino. Për realizimin e këtyre punimeve është e domosdoshme që shoqëria të disponojë pikën e licencës N.S. 18-A “Punime Topogjeodezike”. Për sa më sipër pretendimi nuk qëndron. Lidhur me arsyen tjetër të skualifikimit, ankimuesi pretendon se ky dokument në Itali nuk lëshohet dhe për këtë pikë ka lëshuar një deklaratë për xhiron e tre viteve të fundit. Në kërkesat për kualifikim pranohet që nëse dokumentet e kërkuara në Kërkesat e Përgjithshme për Kualifikim nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës atëhere dorëzon një deklaratë me shkrim. Por vetëdeklarimi nuk pranohet për plotësimin e Kërkesave të Veçanta për Kualifikim. Komisioni konstaton se ky vërtetim nuk është paraqitur as nga dega e shoqërisë në Shqipëri, ku një vërtetim i tillë lëshohet. Për sa më sipër, pretendimi i parashtruar nuk qëndron. Lidhur me arsyen tjetër të skualifikimit, Komisioni konstatoi se vlera e plotë e faturave të paraqitura pa TVSH është 850,180 Euro. Duke qenë se shoqëria “Riviera” sh.p.k. ka kryer vetëm 50 % të këtyre punimeve, vlera e punës e realizuar prej saj (sipas faturave të paraqitura) është rreth 59,500,000 lekë. Shoqëria “Riviera” sh.p.k. si shoqëri e cila ka përqindjen më të madhe në bashkim (51%) duhet të paraqiste dokumentacion për realizimin e punëve të ngjashme në masën 204,087,628 lekë pa TVSH në një punë të vetme (50 % e vlerës së fondit limit). Edhe nëse do të konsiderohej si punë e ngjashme e gjithë vlera e paraqitur në faturat e dorëzuara në tender kjo shoqëri nuk plotëson kërkesën pasi vlera totale e faturave është 850,180 euro ose rreth 119,000,000 lekë. Nga kjo punë shoqëria “Riviera” sh.p.k. ka kryer 50 % të saj, pra vetëm 59,500,000 lekë punime. Sa më sipër pretendimi nuk qëndron.[...]”

II.7. Në datën 11.03.2016 bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se në datën 11.03.2015 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "CAUSHI/M" sh.p.k.	261,521,000	Lekë	skualifikuar;
2. "RSM Company" sh.p.k.	276,464,422	Lekë	skualifikuar;
3. "Company Riviera 2008"	280,575,438	Lekë	skualifikuar;
4. "Curri" sh.p.k.	290,957,430	Lekë	skualifikuar;
5. BO "Riviera" sh.p.k. & "Kostruttiva" degë e shoqërisë së huaj	325,102,100	Lekë	skualifikuar;
6. "Alba Konstruksion" sh.p.k.	327,613,890	Lekë	skualifikuar;
7. "B-93" sh.p.k.	335,597,220	Lekë	skualifikuar;
8. "Tirrena Scavi" S.p.A.	336,635,315	Lekë	skualifikuar;
9. "Arifaj" sh.p.k.	348,924,499	Lekë	skualifikuar;
10. "Victoria Invest International" sh.p.k.	360,087,983	Lekë	skualifikuar;
11. "A. N. K." sh.p.k.	364,625,890	Lekë	kualifikuar;
12. "ALB - STAR sh.p.k.	365,225,026	Lekë	skualifikuar;
13. "ALKO-IMPEX General Construcion" d.sh.h.	366,500,600	Lekë	skualifikuar;
14. "GENER 2" sh.p.k.	375,977,276	Lekë	kualifikuar;
15. "T.T.A ALBA LAM" sh.p.k.	388,623,101	Lekë	skualifikuar;
16. "SENKA/L" sh.p.k.	400,000,000	Lekë	skualifikuar;
17. "ROSI" sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike			

II.8. Në datën 16.03.2016 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Riviera" sh.p.k & "Kostruttiva S.C.P.A." degë e shoqërisë së huaj mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se "[...]Të skualifikojë bashkimin e përkohshëm të shoqërive "Riviera" shpk (51%) dhe "Kostruttiva" shpk (49%) për arsye se: Shoqëria "Kostruttiva" shpk nuk plotëson pikën 2 të Kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim pasi vërtetimi i lëshuar nga Agenzia Entrate mban datën 14 shtator 2015, pra është përtej afatit tre mujor të vlefshmërisë. [...]". Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.1.1. Në Shtojca 10, "Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit", pika 2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është kërkuar:

"Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
- b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,
të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.”

III.1.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj (d.sh.h.), “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. *Vërtetim Nr. 86164 protokollit datë 26.11.2015 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për shoqërinë “Kostruttiva” d.sh.h., me anë të së cilës vërtetohet se dega e shoqërisë së huaj, “Kostruttiva” d.sh.h. [...] deri më datë 25.11.2015 nuk ka detyrime tatimore në TVSH,Tatim Fitim, TAP,dhe kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.*
- ii. *Vërtetim i lëshuar nga Agenzia Entrate, Drejtoria Rajonale Veneto mbi “Ekzistencës së Kontestimeve në Vazhdim dhe akuzave të pazgjidhura që rezultojnë nga sistemi informativ të regjistrimit të taksave”, datë 14 shtator 2015, i përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe i vërtetuar para noterit publik në Republikën e Shqipërisë i nënshkrimit të përkthyesit.*

III.1.3. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se dokumenti i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Veneto për shoqërinë “Kostruttiva S.C.P.A.” (shoqërisë së huaj themeluese të degës në Republikën e Shqipërisë), shoqëri e regjistruar në regjistrat publikë të shtetit Italian, është një dokument zyrtar i lëshuar nga një organ publik i një shteti të huaj. Me anë të ligjit nr.9060 datë 8.5.2003 Republika e Shqipërisë ka ratifikuar “Konventën për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja”, (këtu e në vijim Konventa e Hagës). Në nenin 1 të Konventës së Hagës parashikohet se: “[...] Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë.Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare:a) dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretariatë e gjykatave dhe zyrat përmbartimore;b) dokumentet administrative;c) aktet noteriale;d) vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si edhe vërtetimin zyrtar e noterial të vërtetësisë së firmave.[...]” . Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se akti i mësipërm (Vërtetim i lëshuar për shoqërinë e huaj, themeluese të degës në Shqipëri) është një akt administrativ në kuptim të Konventës së Hagës. Si

i tillë, akti administrativ duhet të ishte legalizuar (me vulë Apostille) në zbatim të nenit 2 dhe vijues të Konventës së Hagës. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se dokumentacioni i mësipërm i lëshuar nga një shtet i huaj nuk përmbush kushtet formale për përdorim në Republikën e Shqipërisë *(duke përfshirë edhe dorëzimin e tij për vërtetimin se subjekti nuk ka detyrime tatimore, në një procedurë prokurimi)*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi si edhe kriteret e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedureve të prokurimit publik. Dokumentacioni i paraqitur nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Konstruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.4. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se dokumentacioni i mësipërm, megjithëse nuk përmbush anën formale është gjithashtu jashtë afatit 3 (tre muaj) të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues se *“Në këtë rast, siç citohet edhe në vërtetimin e lëshuar nga “Agenzia delle Entrate”, në nenin 41 pika 1 DPR n.445 datë 28.12.2000 përcatkohet vlefshmëria e këtij vërtetimi e cila është mbi 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit. Pra mbi këtë dhe çdo dokument tjetër të shoqërisë “Kostruttiva” SCPA vepron ekzkluzivisht ligji dhe normativa italiane dhe nuk vepron në asnjë mënyrë të mundshme ligji dhe normativa shqiptare cili rregullon vlefshmërinë e vërtetimeve shqiptare.”*, Në nenin 4, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se *“E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”*, Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin se nuk është në kompetencën dhe juridiksionin e tij interpretimi i një norme juridike të një shteti të huaj, por nënvizon faktin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik organizuar konform ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik” të ndryshuar*, në Republikën e Shqipërisë janë të detyruar të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me LPP, aktet normative në zbatim të tij dhe dokumenteve të procedurës së prokurimit publikuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, megjithëse vlefshmëria e aktit juridik në një shtet të huaj (në Republikën e Italisë) ka një kohëzgjatje më të madhe se tre muaj (parimi i zbatimit të ligjit në hapësirë), për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit në Republikën e Shqipërisë, dokumentacioni në përmbushje të Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit nuk duhet të jetë i lëshuar më parë se tre muaj para datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues se ndodhemi në rastin klasik të mbrojtës nga neni 45 pika 2 gërma *“dh”* të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik” të ndryshuar*, i cili parashikon se *“Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;”*, K.P.P. gjykon se referuar interpretimit teleologjik (qëllimit të normës juridike), lidhet *strictu sensu* me vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve tatimore të një operatori ekonomik të regjistruar në një

shtet të huaj në përputhje me kuadrin ligjor në shtetin e origjiniës (shkalla e taksimit, lloji dhe natyra e taksave, etj.) dhe në asnjë rast me vlefshmërinë e dokumentacionit të dorëzuar në një procedurë prokurimi zhvilluar në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se “[...]Shoqëria “Kostruttiva” nuk plotëson kërkesën 2.1.e të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit lidhur me likuidimin e detyrimeve të OSHEE pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e kërkuar. Për të provuar likuidimin e detyrimeve ka paraqitur një librezë (që nuk kuptohet se kujt i përket), një kontrate nënqeraje me zotin Trojan Pavloffski dhe një vërtetim nga OSHEE që zoti Trojan Pavloffski nuk rezulton debitor ndaj OSHEE. Këto dokumenta nuk provojnë që shoqëria “Kostruttiva” nuk ka detyrime ndaj OSHEE. [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.2.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 gërma “d” të dokumentave standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar: “d) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik i regjistruar në Shqipëri”

III.2.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Riviera” sh.p.k. & “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Vërtetim dt.16.11.2015 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Eenergjisë Elektrike me anë të të cilit vërtetohet se:

[...]nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën me kod TR2A110079180653 titullar i të cilës është z. T.Pavloffski nuk rezulton debitor për faturat e energjisë nuk rezulton debitorë për faturat e energjisë pranë OSHEE Sh.a. Tiranë. Konfirmojmë se në emër të z. T.Pavloffski është vetëm kjo kontratë furnizimi me energji elektrike në Tiranë e hapur në datë 20.05.2008, Adresa Rr. B.Biba, Familjar.

- ii. Kopje të libeze të energjisë elektrike, me mbishkrimin “Pagesa e vitit 2015”
- iii. Kontratë nënqeraje datë 01.02.2015

III.2.3 Në Nenin 26 “Kontrata e Punëve”, pika 7, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: [...]Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur

rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

III.2.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Në Nenin 48, pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se “ [...] Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë: b) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore [...]”

III.2.5. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë:

“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

- 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).*
- 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.*
- 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.*

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimt bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

- 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.*
- 2. Konsumatori rezulton debitor.*

3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.
4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.
5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]

Gjithashtu referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 30.03.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 6287/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, në të cilin dorëzohet një kopje e formatit standard të lëshimit të vërtetimit të debisë nga ku rezulton se është si më poshtë vijon:

“[...] Bazuar në deklarinimit e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. _____ vërtetohet se kërkuesi _____ nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratata (me kod) _____, titular i së cilës/cilavë është _____ rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e përlllogarituri deri në datën _____. _____ pa përfshirë faturën koherente të muajit _____ [....]

III.2.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit në drejtim të vërtetimit se ka përmbushur të gjithë detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të operatorit ekonomik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë (shoqëria “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj), K.P.P. konstaton se dokumenti i lëshuar nga OSHEE Sh.a. nuk përmbush anën formale të tij, pasi është një dokument i lëshuar jo sipas formatit zyrtar të miratuar nga vetë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Akoma më tej, K.P.P. konstaton se në asnjë rast nuk vërtetohet se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj, ka përmbushur të gjithë detyrimet e energjisë elektrike të maturuara në Republikën e Shqipërisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se akti normativ në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se *strictu sensu* operatorët ekonomik për të dëshmuar se kanë shlyer të gjithë detyrimet e energjisë elektrike duhet të dorëzojnë në S.P.E. vërtetimin e lëshuar nga *Furnizuesi i energjisë elektrike* (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike –OSHEE). Pretendimet e palës ankimuese se “[...] Në bazë të konceptit minimal juridik, ka prezantuar siç e konfirmoni ju, kontratën e nënqirasë me pronarin T.P.librezën e shlyerjes së detyrimeve nga ky i fundit dhe vërtetimin në emër të pronarit të objektit të paluajtur, pra selisë së “Kostruttivës”. Pra objekti pronë e z. T.P. nuk ka detyrime, I njëjti objekt është edhe selia ligjore në Tiranë e Shoqërisë “Kostruttiva” e cila si rrjedhojë nuk ka detyrime në OSHEE [...]” nuk mund të merren në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik, pasi këto janë marrëdhënie që lindin mes konsumatorit (palës ankimuese në rastin konkret) dhe OSHEE Sh.a. Në nenin 26, pika 7 gërma “d” të VKM 914/2014 ku parashikohet se: “Furnizuesi i energjisë elektrike është i

detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.” Akoma më tej, K.P.P. konstaton se referuar vërtetimit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në asnjë rast nuk sqarohet se për cilën periudhë është lëshuar vërtetimi nga OSHEE Sh.a. si edhe cilën fature koherente përfshin, ose jo vërtetimi i mësipërm. Gjithashtu, në rastin konkret të shqyrtimit administrative, K.P.P. konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. nuk ka pasqyruar asnjë dokument provues për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, ndërkohë që referuar dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E., K.P.P. konstaton se në asnjë rast nuk vërtetohet se faqja përkatëse është librezë e shlyerjes së detyrimeve të operatorit ekonomik ankimes, referuar numrit të kontratës apo pronësisë së saj, pasi nuk përmban numër kontrate dhe përkatësi pronësie.

III.2.7. Akoma më tej, referuar vërtetimit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.P.P. konstaton se OSHEE Sh.a shprehet se *“Konfirmojmë se në emër të z. T.Pavlofski është vetëm kjo kontratë furnizimi me energji elektrike në Tiranë e hapur në datë 20.05.2008, Adresa Rr. B.Biba, Familjar.”* Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr. 109, datë 21.10.2011 *“Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”*, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titullekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kontratat e deklaruara nga operatori ekonomik “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. i përkasin personave fizikë të cilët e paguajnë energjinë elektrike me tarifa familiare, ndërsa sipas *ekstratit të regjistrit tregëtar* operatori ekonomik “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h., ka një vend ku ushtron aktivitetin e tij në Njësinë Bashkiake Nr. 9, Rr. “Barrikadave” Nr.11 hyrja 6, kati 7. Duke qënë se shoqëria “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. ushtron veprimtari biznesi, por pagesën e energjisë elektrike e ka bërë sipas tarifave familjare, nuk jemi në kushtet e parashikuara në nenin 9 të VKM-së nr.109 si më sipër cituar, e cila i referohet kontratave të furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë. Sipas shkresës nr.6287/1 prot., datë 30.03.2015 të OSHEE-së, si më sipër cituar, kriteri bazë që duhet të plotësohet për pajisjen me Vërtetim Debie është deklarimi vullnetar i të gjithë kontratave të furnizimit me energji elektrike për të gjithë objektet e ushtrimit të aktivitetit të subjektit sipas ekstraktit të regjistrit tregëtar detyrim i cili nuk është zbatuar nga ana e shoqërisë “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. e cila ka sjellë si pasojë mospagimin e diferencës së detyrimit të lindur midis tarifimit si biznes dhe atij familiar. Pra operatori ekonomik “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. me dokumentacionin e dorëzuar prej tij nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ka paraqitur një dokument për kontratat e furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi

për kontratën e furnizimit me energji elektrike të operatorëve ekonomikë, të cilët i nënshtrohet tarifave më të larta të pagimit të energjisë elektrike.

III.2.9. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar kontratës së qirasë dorëzuar në S.P.E. nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. si edhe vërtetimit të lëshuar nga OSHEE Sh.a. rezulton se *Konfirmojmë se në emër të z. T.Pavloffski është vetëm kjo kontratë furnizimi me energji elektrike në Tiranë e hapur në datë 20.05.2008, Adresa Rr. B.Biba, Familjar.* Ndërkohë referuar ekstratit të regjistrit tregëtar operatori ekonomik “Kostruttiva” d.sh.h., ka një vend ku ushtron aktivitetin e tij në Njësinë Bashkiake Nr. 9, Rr. “Barrikadave” Nr.11 hyrja 6, kati 7 (adresa e selisë) duke qenë në thelb dy adresa të ndryshme, adresa e ushtrimit të aktivitetit (selisë) dhe adresa referuar kontratës së furnizimit për të cilin është lëshuar edhe vërtetimi nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se “[...]Shoqëria “Kostruttiva” shpk nuk plotëson pikën 2.4.5 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me disponimin e licensave, pasi mungon pika e licensës NS 18 ”Punime topogjeodezike”, e domosdoshme për të realizuar punimet që ka marrë përsiper kjo shoqëri sipas marrëveshjes së bashkëpunimit. [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.3.1. Në Shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar:

“[...] Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme sipas modelit nga MPPTT:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.P – 1. A Punime gërmimi në tokë.

N.P – 4. D Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

N.P - 5. A Punime nentokesore.

N.P - 7. A Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje

N.P – 11.B Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

N.P – 12. B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S – 1. A Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S – 6. A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
N.S – 7. A Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
N.S – 10. B Shtresa dhe mbistruktura speciale.
N.S – 13. A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
N.S – 18. A Punime topogjeodezike.[...]

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Riveira” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. ka dorëzuar :

- Kontratë Bashkëpunimi Nr.137 Rep. dhe Nr.37 Kol. datë 26.01.2016 hartuar para noterit publik në Republikën e Shqipërisë me anë të së cilës është krijuar “*Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Riviera” sh.p.k. & “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h.*”
- Licencë NZ.7207/2, lëshuar për shoqërinë “*Kostruttiva S.C.P.A.*” degë e shoqërisë së huaj, ku rezulton se në seksionin “*Drejtues Ligjor*” është deklaruar z. Devis Rizo.
- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) për shoqërinë “*Kostruttiva*” degë e shoqërisë së huaj;

III.3.3. Para shqyrtimit në themel të pretendimit të anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomike, K.P.P. konstaton se Licencë NZ.7207/2, lëshuar për shoqërinë “*Kostruttiva S.C.P.A.*” degë e shoqërisë së huaj, ku rezulton se në seksionin “*Drejtues Ligjor*” është deklaruar z. Devis Rizo. Në kreun III “*Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet*”, pika 2 dhe pika 3 gërma ”a”, paragrafi 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, parashikohet se: 2. *Elementet e licencës: a) Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4); III. Numrin e identifikimit; IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. **Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë**; VI. Selinë;VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).* “[...] 3. *Shoqëritë e huaja që aplikojnë për licencim njehsojnë licencën që disponojnë nga vendi i origjinës duke zbatuar të njëjtat procedura për kategorizimin dhe klasifikimin, si dhe shoqëritë shqiptare.*[...]”

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në Licencë NZ.7207/2, lëshuar për shoqërinë “*Kostruttiva S.C.P.A.*” degë e shoqërisë së huaj, ku rezulton se në seksionin “*Drejtues Ligjor*” është deklaruar z. Devis Rizzo si “*Drejtues i vetëm ligjor*”. Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregëtar të shoqërisë “*Kostruttiva*” degë e shoqërisë së huaj, në seksionin

“Përfaqësuesi Ligjor i degës/zyrës së përfaqësimit” është zj. Angela Federica Marin dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së huaj është z. Devis Rizzo.

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se licenca e lëshuar për shoqërinë “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj megjithëse është lëshuar nga institucioni përgjegjës (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit) shfaq të meta dhe nuk përmbush të gjithë detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normative në zbatim të ligjit VKM Nr.42, datë 16.1.2008 *“Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se Licenca NZ.7207/2, e shoqërisë “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj, është njëhësim (konvertim) i licencës së shoqërisë së huaj (“Kostruttiva” S.C.P.A. regjistruar në regjistrat e shtetit Italian). Sa më sipër, për njëhësimin e licencës së shoqërisë së huaj për degën e saj të regjistruar në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen të njëjtat *procedura për kategorizimin dhe klasifikimin, si dhe shoqëritë shqiptare*. Në kreun I *“Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime”* pika 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 *“Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, parashikohet se: *“Drejtues ligjor”-personi fizik apo personat fizikë (administrator për sh.p.k., drejtor, presidenti për sh.a., personi fizik) të përcaktuar si të tillë nga vendimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/ ose në gjykatë*. Referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar të anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes “Kostruttiva” degë e shoqërisë së huaj rezulton se përfaqësuesi ligjor për degën (operatori ekonomik ankimes) është zj. Angela Federica Marin. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përcaktimi i përfaqësuesit ligjor në licencën e shoqërisë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin për përfaqësuesin ligjor të shoqërive. Në rastin konkret përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj është zj. Angela Federica Marin e cila ushtron të gjithë kompetencat e administratorit të degës (operatorit ekonomik ankimes) në Republikën e Shqipërisë. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se licenca e dorëzuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes shfaq të meta në drejtim të deklaramit të përfaqësuesit ligjor. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së huaj Z. Devis Rizzo, i deklaruar si përfaqësues ligjor në licencën e dorëzuar në S.P.E. gëzon tagra të kufizuar vetëm për ushtrimin e aktivitetit në Republikën e Italisë dhe në asnjë rast nuk gëzon tagra të ushtrimit të kompetencës së tij në Republikën e Shqipërisë. Akoma më tej, referuar nenit 95 pika 2 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 *“Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”*, i ndryshuar parashikohet se: *“Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm”*. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se deklarimi vetëm i administratorit të shoqërisë së huaj në licencën lëshuar për degën e shoqërisë (operatorin ekonomik ankimes) nuk është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

III.3.6. Akoma më tej, në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “[...] Shoqëria “Kostruttiva” s.c.p.a. nëse vini re ka një licencë italiane dhe një të njësuar nga Ministria e Transporteve me kategoritë e palimituara në nivelet më të larta të specializimit të punëve të cilat ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Është shumë tendencioz ky motiv skualifikimi megjatë në çdo rast e mbulon anëtari dhe kryetari i grupit “Riviera” sh.p.k.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues kanë nënshkruar kontratë Bashkëpunimi Nr.137 Rep. dhe Nr.37 Kol. datë 26.01.2016 hartuar para noterit publik në Republikën e Shqipërisë me anë të së cilës është krijuar “Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Riviera” sh.p.k. & “Kostruttiva” d.sh.h. Referuar nenit 3 “Ndarja e Punimeve” të kontratës së mësipërme, është parashikuar si më poshtë vijon “[...] Llojet e punimeve që do të kryhen nga secila palë për Sipërmarrjen e Përbashkët përcaktohet në Aneksin Nr.1 kësaj kontrate bashkëpunimi, “Riviera” sh.p.k. do të kryejë 51 %, “Kostruttiva s.c.p.a.” 49 %. Referuar Aneksit Nr.1 të kontratës së bashkëpunimit “Preventivit të Punimeve”, K.P.P. konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, “Riviera” sh.p.k. “Kostruttiva S.C.P.A” d.sh.h., ndër të tjera ka marrë përsipër kryerjen e punimeve si më poshtë vijon: “(F.V. Bordura Mermeri (Luzerna), ndarëse me trotuarin 25x30; F.V. Bordura Mermeri (Luzerna), fundore e trotuarit 10x20; F.V. Bordura Mermeri (Luzerna), e kthyer 10x20; “Punime në rrjetin e Ujësjellësit”- F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=200mmm P=10 atm; F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=160 mmm P=10 atm; F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=90 mmm P=10 atm; F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=750 mmm P=10 atm; Punime në KUZ- F.V. Tub Betoni D=800 mmm; C-3 “Tombinot”(të gjithë zërat e preventivit), punime për të cilat shfaqet e nevojshme që shoqëria të disponojë pikën e licencës N.S. 18-A “Punime Topogjeodezike”.

III.3.7. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.”3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato

teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.3.7. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vendosja e kriterit të sipërcituar ka si qëllim të sigurojë autoritetin kontraktor mbi aftësinë teknike të operatorëve ekonomikë fitues potencialë, në drejtim të përmbushjes së kontratës dhe detyrimeve të saj, sipas standardeve të përcaktuara. Në zbatim të nenit 74 pika 3 e VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, kërkesat teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Sa më sipër, paraqitja e dokumentacionit të kërkuar, për vetëm njërin prej tyre, sjell automatikisht kryerjen e punimeve të marra përsipër nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë në kushtet e mungesës së dokumentacionit tekniko-ligjor për anëtarin tjetër të bashkimit të operatorëve. Për sa kohë që në kontratën e bashkëpunimit janë marrë përsipër kryerja e punimeve si F.V. Bordura Mermeri (Luzerna), ndarëse me trotuarin 25x30; F.V. Bordura Mermeri (Luzerna), fundore e trotuarit 10x20; F.V. Bordura Mermeri (Luzerna), e kthyer 10x20; “Punime në rrjetin e Ujësjellësit”- F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=200mmm P=10 atm; F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=160 mmm P=10 atm; F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=90 mmm P=10 atm; F.V. “HDPE 100, SDR 17, Dj=750 mmm P=10 atm; Punime në KUZ- F.V. Tub Betoni D=800 mmm; C-3 “Tombinot”(të gjithë zërat e preventivit), punime për të cilat shfaqet e nevojshme që shoqëria të disponojë pikën e licencës N.S. 18-A “Punime Topogjeodezike”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm, nuk është plotësuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj.

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” degë e shoqërisë së huaj mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se “[...]Shoqëria “Riviera” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kërkesave të Përgjithshme të Kualifikimit pasi ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Tatimore Tirane, në të cilin , ndër të tjera citohet: “... rezulton se për periudhën deri në datë 08.01.2016, nuk ka detyrime tatimore në tvsh, tatim fitimi, tatim mbi të ardhurat personale, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatim në burim, por vetëm gjoba dhe interesa për të cilat ka lidhur aktmarrëveshje për pagesat me këste...”. Në këtë menyre, duke qenë se ky subjekt përvec gjobave ka edhe interesa të pa paguar, nuk plotëson këtë kërkesë për kualifikim. [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.4.1. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.4.2. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.4.3 Në Shtojcën 10 pika 2 të “Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet shprehimisht se: - *Ofertuesi duhet të paraqesë një dokument që vërteton se subjekti: a) Ka plotësuar detyrimet fiskale b) Ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqëror , të lëshuara nga Administrata Tatimore*

III.4.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Riveira” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h., “Riviera” sh.p.k. ka dorëzuar :

- i. Vërtetim Nr.1127 Protokoli datë 08.01.2016 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën vërtetohet se “[...] deri në datën 08.01.2016 nuk ka detyrime tatimore në TVSH, Tatim Fitim, Tatim mbi të Ardhurat Personale, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore, por vetëm gjoba dhe interesa, për të cilat ka lidhur akt marrëveshjen për pagesën me këste nr.40455/1 protokoli datë 25.06.2015;
- ii. Akt Marrëveshje nr.40455/1 protokoli datë 25.06.2015 lidhur mes palëve “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Shoqëria “Riviera” sh.p.k.

III.4.5. Në nenin 28 pika 2 të “VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar” parashikohet se “Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë: a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;. Duke qenë se një situatë e tillë nuk rregullohet nga *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për interpretimin e togfjalëshit “detyrim tatimor” në rastet kur akti administrativ “Njoftim vlerësimi tatimor” është në proces shlyerje me këste, do të konsiderohet ose jo “detyrim” për qëllim të kualifikimi në procedurat e prokurimit publik, gjykon ti drejtohet për interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik). Për të arritur në vendimarrje të drejtë, K.P.P. gjykon se duhet ti drejtohet, ligjit të posaçëm (*lex specialis*) Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” të ndryshuar, në nenin 6 pika 3 parashikon se “Me detyrim tatimor” nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjokat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”. Në nenin 77 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” të ndryshuar parashikohet se “1. Kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar plotësisht dhe në afat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë marrëveshje pagese me këste. 2. Tatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste. Kërkesa duhet t’i drejtohet drejtorit të drejtorisë rajonale apo drejtuesit të njësisë të ngjashme me të dhe duhet të parashtrijë arsyet, që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet tatimore. 3. Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të dhe tatimpaguesi. 4. Marrëveshja e pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës. 5. Administrata tatimore mund ta refuzojë kërkesën për një marrëveshje pagese me këste ose të kërkojë garanci bankare, para se të hyjë në një marrëveshje të tillë. 6. Tatimpaguesi duhet të paguajë kamatëvonesë për të gjitha detyrimet tatimore, pagesa e të cilave shtyhet, sipas marrëveshjes së pagesës me këste”

III.4.6. Organi i Administratës Tatimore me anë të Akt-Marrëveshjes, ka lejuar pagesën me këste të detyrimeve deri në muajin Qershor të vitit 2016, duke i krijuar lehtësi operatorit për përmbushjen e detyrimeve fiskale. Paraqitja e Akt- Marrëveshjes, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk mund të konsiderohet se përmbush kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 10 pika 2 të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit “Për shlyerjen e detyrimeve fiskale”, pasi detyrimi konsiderohet i përmbushur deri në momentin e pagesës së këstit të fundit, i cili sipas Akt -Marrëveshjes përkon me muajin Qershor të vitit 2016. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin se edhe në praktika të tij të mëparshme *mutatis mutandis* dhe *inter allia* është shprehur se paraqitja e një marrëveshje të lidhur me administratën

tatimore për pagimin me këste nuk pasqyron në asnjë rast se operatori ekonomik nuk ka detyrimet fiskale në kuptim të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. mbi skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe bashkimi operatorëve ekonomikë ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tyre faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “BO “Riviera” sh.p.k & “Kostruttiva S.C.P.A.” d.sh.h. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-21321-12-29-2015 me objekt “Ndërtim i Rrugës Dhimitër Konomi (mbi Rrap) Vlorë” me fond limit 408,175,256 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 27.01.2016 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 532 Protokoli; Datë 11.03.2016;

I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri